

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9920, DATË 19.5.2008, “PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Përgatitja e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

Ky projektligj synon rregullimin e funksionimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale ekzistuese deri në fillimin e efekteve të ligjit nr.87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky amendim nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2020, ndërkohë sqarojmë se në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve (PPAP) 2020, janë propozuar amendime të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” në kuadër të paketës fiskale 2021.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia globale COVID-19, si dhe problematikave të shkaktuara nga pikëpamja ekonomike dhe sociale, është propozuar shtyrja e fillimit të efekteve të ligjit nr.87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, për transaksionet me para në dorë, për në 1 shtator 2021, ndërkohë që, aktualisht, afati më i parë për fillimin e efekteve të këtij ligji është 1 shtator 2020. Në këto kushte, lind e nevojshme që paralelisht, të bëhet një rregullim lidhur me funksionimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve fiskale ekzistuese (të cilat përdoren për transaksionet me para në dorë) deri në momentin e fillimit të efekteve të ligjit për faturën dhe sistemin e

monitorimit të qarkullimit. Duke qenë se pajisjet fiskale ekzistuese rregullohen nga dispozitat e ligjit për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, rregullimi i nevojshëm adresohet te dispozita kalimtare e këtij ligji.

Aktualisht, të dhënat e transaksioneve me para në dorë të tatimpaguesve raportohen nëpërmjet sistemeve fiskale ekzistuese. Këto sisteme do të vazhdojnë të funksionojnë në të njëjtën mënyrë deri në fillimin e efekteve ligjore të ligjit të fiskalizimit.

Me qëllim dhënien e mundësisë tatimpaguesve për të mos e ndërprerë aktivitetin për një periudhë 30-ditore, kur konstatohet shkelja sipas paragrafit “ii”, të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 122, të ligjit, propozohet heqja e masës së bllokimit të aktivitetit përpara afatit 30-ditor, nëse tatimpaguesi shlyen të plotë dënimin (tatim, kamatvonesë dhe gjobat) sipas këtij paragrafi.

Gjithashtu, me këtë projektligj parashikohet një rregullim në pikën 3, të nenit 136 “Shfuqizime”, të ligjit për procedurat tatimore, me qëllim qartësimin e parashikimeve të kësaj dispozite.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrimin me ndonjë *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 4 nene.

Neni 1 parashikon heqjen e masës së bllokimit të veprimtarisë përpara afatit 30-ditor, nëse tatimpaguesi paguan dënimin, sipas paragrafit “ii”, të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 122.

Neni 2 parashikon që në kreun XV, pas pikës 5, të nenit “Dispozitave kalimtare”, shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:

“6. Pajisjet fiskale, të ofruara nga shoqëritë e autorizuara, me të cilat janë pajisur tatimpaguesit para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vijojnë të funksionojnë dhe të mirëmbahen nga këto shoqëri, për aq sa nuk bien në kundërshtim me ligjin nr.87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.

Deri në datën e fillimit të efekteve juridike, sipas nenit 48, të ligjit nr.87/2019, shoqëritë që kanë qenë të autorizuara, sipas vendimit nr.781, datë 14.11.2007, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe iu ka përfunduar afati i autorizimit, përpara apo gjatë periudhës kalimtare, vazhdojnë të ofrojnë shërbimin e mirëmbajtjes të pajisjeve fiskale për tatimpaguesit. Përcaktimet e këtij paragrafi nuk përjashtojnë përmbushjen e detyrimeve sipas ligjit nr.87/2019.”.

Neni 3 parashikon që në pikën 3, të nenit 136, fjalët “... Nga data e fillimit të zbatimit të këtij ligji, ...” të zëvendësohen me “... Në momentin e shfuqizimit të neneve 55 dhe 56, të këtij ligji, ...”.

Neni 4 parashikon hyrjen në fuqi të këtij ligji 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTAKTI

Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij projektligji.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe u soll për shqyrtim e miratim në Këshillin e Ministrave si propozim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi dhe zbatimi i këtij projektligji nuk parashikohet të sjellë efekte financiare në buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE